



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4159/Prot.

2

Tiranë, më 02. 2.2022

VENDIM

Nr. 01, datë 31.01.2022

“Për miratimin paraprak të tarifave për marrjen e titullit “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Tiranës”.

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenet 3, pika 3/ç; 38, pikat 1 dhe 3; 79, pika 5; dhe; Statutit të Universitetit të Tiranës nenet 7, pika 3/ç, 38 dhe 98.; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; VKM-së nr. 112 datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” të ndryshuar; Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”; si dhe me propozim të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik; Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 31.01.2022,

VENDOSI:

1. Të përcaktojë tarifën në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për ndjekjen e procedurës së fitimit të titullit “Profesor i Asociuar” në Universitetin e Tiranës.
2. Të përcaktojë tarifën në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për ndjekjen e procedurës së fitimit të titullit “Profesor” në Universitetin e Tiranës.
3. Për aplikantët të cilët janë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës, tarifa të përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit.
4. Për aplikantët të cilët vijnë nga jashtë Universitetit të Tiranës, tarifa të përballohet nga vetë aplikanti, ose, sipas marrëveshjes që palët kanë rënë dakord ndërmjet tyre, nga institucioni nga vjen aplikanti.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet për të gjithë aplikimet që kryhen pas hyrjes së këtij vendimi në fuqi.



KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha